

VENDIM
Nr. 17, datë 20.1.2021

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË FILLUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 230, DATË 15.12.2020, “MBI FILLIMIN E
PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 415, SERIA P18K, PËR
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË
SHOQËRISË ‘BLAC ENERGY’ SHPK ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 157,
DATË 9.7.2018”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 95, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe të nenit 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 9/10 prot., datë 16.1.2021, të përgatitur nga Grupi i punës, “Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 15.12.2020, ‘Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Blac Energy’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 230, datë 15.12.2020, vendosi për fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 230, datë 15.12.2020, i është dërguar për dijeni shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k. nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1172/9-1 prot., datë 23.12.2020.

- Në vijim të këtij njoftimi, në datën 13.1.2021, nga verifikimet e Drejtorisë së Financës në ERE, rezultoi dhe u bë me dije se janë shlyer detyrimet për pagesat e rregullimit për të cilat rezulton debitore shoqëria.

- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dijeni të subjektit, rezulton se subjekti ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit të përcaktuar në këtë njoftim e të sanksionuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230/2020.

- Për sa më sipër, rezulton se shoqëria “Blac Energy” sh.p.k. nuk është debitore ndaj ERE-s për pagesat e prapambetura të rregullimit.

- Në nenin 8, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: Pas marrjes së përgjigjes më shkrim nga i licencuari, sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentet e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari dhe do t'i propozojnë Bordit: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës, në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat: “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d”, të nenit 5, të kësaj rregulloreje.

- Në nenin 95, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

- Dispozitat e nenit 95 zbatohen për çdo procedurë administrative, pavarësisht nëse është filluar kryesisht nga organi publik ose me kërkesë të palës. Në këtë rast “qëllimi” i procedurës lidhet ngushtësisht me marrjen e masave ligjore, kryesisht nga organi që ka kompetencën, me qëllim shmangien e faktorit që ka nxitur vendimmarrjen.

- Vërtetimi i shlyerjes së pagesave të prapambetura fakton ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i kundrejtohet masa administrative, duke rezultuar në rënien e shkakut që imponoi marrjen e masës ligjore.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Blac Energy’” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018”.

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 230, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Blac Energy’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018”.

3. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti